

## KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Në Tiranë, më datën 28.02.2019 (*dymijë e nëntëmbëdhjetë*) lidhet kjo Kontratë midis palëve për shitblerjen e kuotave të kapitalit të shoqërisë:

### SHITËSI:

- z. **Dëfrim Hima**, datëlindjes 03.06.1993, lindur në Radomire, Dibër e banues në Tiranë, Paskuqan, identifikuar sipas ligjit me anë të Letërnjoftimit nr. 026620738 dhe nr. personal J30603089M, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë **“EBD Trading” Sh.p.k.**, regjistruar si person juridik në datën 25.01.2018, me NUIS: L 81325025 C;

### BLERËSIT:

- z. **Ardian Xhyheri**, i datëlindjes 17.04.1964, lindur dhe banues në Tiranë, rruga “\_\_\_\_\_”, ap. \_\_\_\_\_, Tiranë, identifikuar me Pasaportën nr. BI1060084;
- z. **Ramazan Hima**, i datëlindjes 10.01.1968, lindur dhe banues në Tiranë, rruga “\_\_\_\_\_”, ap. \_\_\_\_\_, Tiranë, identifikuar me Pasaportën nr. BC2712999;

### NENI 1

Shitësi është ortak me 100% të kuotave të shoqërisë “EBD Trading” Sh.p.k., regjistruar si person juridik në datën 25.01.2018, me NUIS: L 81325025 C, me seli në, Rr. e “*Bajram Curri*”, godina ETC, Kati i 12, Ap. nr. 54, Njësinë Bashkiake nr. 1, Zona Kadastrale nr. 8160, Tiranë.

- 1.1 Këto kuota të shoqërisë Shitësi ia shet Blerësve të cilët pranojnë t'i blejnë ato sipas kushteve të përcaktuara më poshtë në këtë kontratë.

### NENI 2

- 2.1 Çmimi i shitjes së kuotës në pronësi të Shitësit, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë “EBD Trading” Sh.p.k., është në vlerën nominale prej 100.000 Lek.


### NENI 3

- 3.1 Blerësit i blejnë kuotat që shet Shitësi, si më poshtë:

**Ardian Xhyheri**, blen 50% të kuotave, dhe bëhet ortak me 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “EBD Trading” Sh.p.k.

**Ramazan Hima**, blen 50% të kuotave, dhe bëhet ortak me 50% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “EBD Trading” Sh.p.k.

- 3.2 Me shitjen e këtyre kuotave, përbërja e ortakëve në shoqërinë “EBD Trading” Sh.p.k. ndryshon dhe bëhet si më poshtë:



**Ardian Xhyheri** zotëron 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.  
**Ramazan Hima** zotëron 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 3.3 Me realizimin e kësaj shitblerje të 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "EBD Trading" Sh.p.k., Blerësve u transferohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga blerja, ndërsa Shitësi largohet nga pjesëmarrja e mëtejshme në këtë shoqëri.

#### NENI 4

- 4.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi kuotën që i transferon Blerësve; nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e saj apo që t'i ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi të deri në datën e sotme; ai e shet këtë kuotë të kapitalit të shoqërisë Blerësve të lirë nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë; të drejtat mbi të nuk janë të përfshira në procese civile, penale, administrative, arbitrazhi apo të çfarëdo lloji natyre tjetër që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së Blerësve mbi kuotën.


#### NENI 5


- 5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.  
5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) ekzemplarë me të njëjtën vlerë ligjore dhe palët pasi e lexuan dhe e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë e nënshkruajnë pa vërejtje.


#### PALËT KONTRAKTORE

**SHITËSI**  
**Dëfrim HIMA**





**BLERËSIT**  
**Ardian XHYHERI**



**Ramazan HIMA**

